



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PERGJITHSHME  
E PARANDALIMIT TE PASTRIMIT TE PARAVE**

---

**Miratohet:**

**Ridvan BODE**

**MINISTER I FINANCAVE**

**RAPORTI VJETOR**

**I**

**DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE PARANDALIMIT TE PASTRIMIT TE  
PARAVE**

Për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2005

Tiranë, Shqipëri  
Mars, 2006

## **Përmbajtja e Lëndës**

- 1. Mesazh i Drejtorit te Pergjithshem**
- 2. Situata e përgjithshme e Drejtorise se Pergjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave (DPPPP)**
  - 2.1 Nje veshtrim kritik mbi rezultatet operationale te vitit 2005**
  - 2.2 Organizimi stukturor dhe organizimi i punes ne DPPPP**
  - 2.3 Vlerësimi i buxhetit per vitin 2006**
    - 2.3.1 Buxheti i kërkuar**
    - 2.3.2 Buxheti i akorduar**
    - 2.3.3 Analiza e shpenzimeve kundrejt buxhetit**
    - 2.3.4 Financime nga donatoret dhe asistenca e huaj**
  - 2.4 Ndërveprimi institucional**
    - 2.4.1 Mbledhje të organizuara me ta**
    - 2.4.2 Raportet e dhëna**
    - 2.4.3 Raportet e marra**
  - 2.5 Ndërveprimi me subjektet raportuese**
    - 2.5.1 Zhvillime**
    - 2.5.2 Raporte të marra nga subjekti raportues**
    - 2.5.3 Raporte të derguara nga NIF ne institucione te tjera**
    - 2.5.4 Gjoba administrative të vendosura për mos-respektim të ligjit, numri i rasteve, vlera dhe sasia sipas monedhës.**
    - 2.5.5 Ndergjegjesimi I publikut**
  - 2.6 Shtojca e informacionit statistikor**
    - 2.6.1 Raporte te marra dhe te dhena sipas sektoreve**
    - 2.6.2 Marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara**
    - 2.6.3 Marrëveshje ndërkombëtare që duhen nënshkruar**
    - 2.6.4 Kërkesa ndërkombëtare te dhena dhe te marra**
    - 2.6.5 Urdhëra ngrirjeje, sipas datës, numrit të llogarisë, emrit dhe sasisë**
- 3. Objektivat per vitin 2006**
  - 3.1 Plani Strategjik**

## **1. Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm**

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) është Njësia e Inteligjencës Financiare Shqiptare (NIF). Një njësi e tillë mbledh informacionin financiar vendas dhe të huaj në mënyrë që të ndihmojë në egzaminimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe aktiviteteve të tjera kriminale brënda kufijve të saj. Ky informacion financiar mbledhet kryesisht nga raportet e detyrueshme të transaksioneve të cilat parashtrihen nga institucionet financiare.

NIF Shqiptar është krijuar përpara pesë vjetësh. Gjatë kësaj periudhe, është zgjeruar dhe është shndërruar nga një agjenci e vogël brënda Ministrisë së Financave në një drejtori me prezencë ndërkombëtare. Për më tepër, është bërë një pjesë integrale e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në Shqipëri.

Viti fiskal 2005 solli si arritje ashtu edhe sfida për NIF. Nga njëra anë, u ndërmorrën një sërë masash në lidhje me pastrimin e parave dhe me transaksionet e financimit të terrorizmit. Përveç kësaj, qëllimi i aktivitetit të NIF u zgjerua në mënyrë të konsiderueshme nëpërmjet nënshkrimit të një numri memorandumesh bashkëpunimi me njësitë homologe ndërkombëtare.

Nga ana tjetër, misioni i NIF vazhdon të vështirësohet për shkak të mungesës së një baze kompjuterike të dhënash për kërkimin dhe analizimin e raporteve të transaksionit. Veprimi në një ekonomi të madhe "cash", si dhe rritja e numrit dhe e llojeve të subjekteve raportuese paraqesin probleme të mëtejshme përputhshmërie. Dhe, megjithëse është një organizatë në zhvillim, NIF ka nevojë për një plan strategjik afat gjatë dhe *avant-garde*.

## **Arritje dhe iniciativa**

**Lufta kunder kriminit dhe korrupsionit.** Roli gjithnjë e në rritje në luftën kundër kriminit dhe korrupsionit është më e evidente se asnjëherë tjetër në rregjimin e parandalimit të pastrimit të parave në Shqipëri. Pastrimi i parave është relativisht një krim i ri në Shqipëri si dhe në shumë vende të tjera të botës. Dhe është gjetur shpesh si indikacion i aktiviteteve kriminale. Pothuaj të gjitha tipet e krimeve qofshin trafikë, mitmarrje, mashtrime në prokurime, vjedhje të medha ose evazion fiskal përfshijnë disa lloj skemash të pastrimit të parave.

Kriminelët kërkojnë të fshehin fitimet e tyre që burojnë nga aktivitete jo të ligjshme dhe punë jo të pastra duke manipuluar transaksionet financiare vendase dhe ndërkombëtare. Përmes mbledhjes dhe analizimit të informacionit nga institucione financiare dhe agjenci shtetërore, NIF është në një pozicion unik për identifikimin e këtyre transaksioneve dhe pjesëmarrësve në to.

NIF e shpërndan këtë informacion tek një numër i caktuar agjencish të zbatimit të ligjit. Disa prej tyre i dërgohen policisë për hetime të mëtejshme dhe të tjera i dërgohen Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm për ndjekje kriminale. Gjatë vitit 2005, janë parashtruar dhjetë raste për hetim dhe katër raste për penalizim të njërit lloj apo tjetrit.

**Veprimet Kunder Financimit të Terrorizmit.** Një nga mësimet e nxjerra pas sulmeve terroriste të 11 Shtatorit 2001 është: identifikimi i rrjeteve të dyshimta të financimit është mënyra më e mirë për të parandaluar aktivitetet e financimit të terrorizmit. Njësia e inteligjencës Financiare si dhe njësitë e tjera të inteligjencës financiare anë e mbanë botës, me aftësitë dhe kompetencat e tyre të veçanta, i janë përgjigjur këtij kërcënimi me rritjen e shkëmbimit të informacionit në lidhje këto rrjete. Këto shkëmbime kanë bërë të mundur që NIF kudo në botë të ndjekin rrjedhën e fondeve të financimit të terrorizmit deri jashtë kufijve të tyre kombëtarë.

Gjatë vitit 2005, NIF ka marrë pjesë aktive në luftën globale kundër terrorizmit. Në aktivitet e saj përfshihen ngrirja e llogarive bankare, urdhëra për bllokimin e pasurive dhe referimi i rasteve kriminale për ndjekje penale. Në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm janë ngritur shtatë akuza për financim të terrorizmit; shtatë urdhëra për bllokime; dhe janë ngrirë dymbëdhjetë llogari bankare. Deri më sot, autoritetet shqipëtare kanë ngrirë, marrë ose sekuestruar pronat e terroristëve në një shumë prej 350,000.00 Euro.

**Iniciativa të Bashkëpunimit Ndërkombëtar.** Ashtu siç u tha edhe më lart, marrëdhëniet ndërkombëtare midis NIF janë zgjeruar gjithnjë e më shumë. Gjatë këtyre pesë viteve të fundit, NIF Shqipëtar e ka zgjeruar në mënyrë thelbësore qëllimin e aktivitet të tij përmes nënshkrimit të marrëveshjeve dy dhe shumë palëshe për shkëmbimin dhe përdorimin e informacionit financiar, veçanërisht me vendet fqinjë. Deri tani, NIF ka nënshkruar njëzetë e katër memorandume bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë. Gjithashtu pjesmarrja e NIF Shqipëtar në komitete ndërkombëtare dhe në grupe të ndryshme pune është një kontribut i mëtejshëm drejt iniciativave tona për bashkëpunim ndërkombëtar.

**Iniciativa Legjislative.** NIF ka kontribuar aktivisht në procesin e përmirësimeve të kudit ligjor. Në Qershor 2003 Task Force inteligjencës Financiare (FATF) paraqiti listën e rishikuar të rekomandimeve që duhet të adoptoheshin nga të gjitha vendet për të forcuar rregjimin kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit. Kjo solli domosdoshmërinë e rishikimit të kuadrit ligjor në Shqipëri në fushën e parandalimit të pastrimit të parave. Gjatë vitit 2006, në vijim të përpjekjeve të saj për të përforcuar programin e saj dhe për të rritur zbulimin e transaksioneve kriminale, NIF do të propozojë disa amendamente të nevojshme për ligjin egzistues të parandalimit të pastrimit të parave.

## **Konkluzion**

Këtë vit NIF Shqipëtar festoi pesë vjetorin e krijimit të tij. Gjatë rrugës sonë të progresit kemi ndërmarrë zgjidhje të reja. Arritjet tona gjatë këtyre pesë viteve të fundit janë rezultat i punës këmbëngulëse të stafit tonë të dedikuar. Sigurisht që puna jonë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

**Sinqerisht,**

**Adriatik ISLAMAJ**

**Drejtor i Përgjithshëm**

## **2. SITUATA E PËRGJITHSHME E DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE PARANDALIMIT TE PASTRIMIT TE PARAVE (DPPPP)**

Vitet e fundit nevoja per nje strategji moderne kunder pastrimit te parave eshte pranuar gjeresisht ne menyre nderkombetare. Ne zhvillimin e strategjise kunder pastrimit te parave, vendet kane pranuar qe strukturat e zbatimit te ligjit kane pasur nje hyrje te kufizuar ne informacionin e nevojshem financiar, per shkak te natyres restriktive te ligjit per ruajtjen e sekretit bankar.

Pas botimit nga Task Forca e Veprimit Financiar (FATF), te 40+9 rekomandimeve, ku sanksionohet qe institucionet financiare duhet te raportonin aktivitetet dhe transaksione te dyshimta, ne Gusht te vitit 2001 u krijua Drejtoria e Bashkerendimit te Luftes Kunder Pastrimit te Parave (DBLKPP), e ndertuar sipas modelit te Njesise se Inteligjences Financiare (NIF) te tipit administrativ.

Shqiperia gjate viteve te fundit ka bere hapa sinjifikative ne drejtim te parandalimit te pastrimit te parave dhe luftes kunder financimit te terrorizmit. Ne fushat e progresit perfshihet edhe ngritja e DBLKPP si drejtori brenda struktures organizative te Ministrise se Financave.

Me kalimin e kohes u pa e nevojshme qe kesaj strukture ti jepej vendi i duhur per te realizuar misionin per te cilen ishte ngritur dhe funksionon. Ne zbatim te ligjit te parandalimit te pastrimit te parave dhe me vendim te Keshillit te Ministrave nr. 108, date 11.02.2005, DBLKPP u zhvillua ne nje nivel me te larte dhe funksionon si Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te Pastrimit te Parave (DPPPP). Kjo menyre organizimi ka dhene efektet e saj ne rritjen e pavaresise operacionale dhe buxhetore si dhe ne shtimin e funksioneve inspektuese te kesaj strukture ne subjektet raportuese.

### **2.1 Nje veshtrim kritik mbi rezultatet operacionale te vitit 2005**

Treguesit e Performances. Performanca e NIF-it mund te matet kryesisht nepermjet dy treguesve. Se pari, numri i transaksioneve te marra krahasuar me numrin e rasteve kriminale dhe investigative te referuara. Ky indikator tregon inteligjencen financiare qe perfitohet nga informacioni i marre. Se dyti, ne lidhje me financimin e terrorizmit, numri i urdherave te leshuar per ngrirjen e asetëve. Ky tregues tregon efektivitetin ne identifikimin dhe sekuestrimin e asetëve te financuara nga terroristet.

Gjate vitit 2005, NIF morri 26.869 raste te transaksioneve te vlerave (RTV) dhe 121 raporte te aktivitetit te dyshimte (RAD). Nga ky informacion, kater raste kriminale jane derguar ne zyren e Prokurorit te Pergjithshem; dhjete te tjera jane derguar ne Polici per investigim te metejshe dhe pjesa e mbetur eshte derguar ne agjensite e tjera detyruese. Nuk ka pasur denime per krimet e lidhura me pastrimin e parave gjate vitit 2005.

Rezultati statistikor tregon qe informacioni mbi te cilin eshte proceduar perben vetem .01% e informacionit te grumbulluar.

Sic eshte permendur me lart, shtate referime jane bere lidhur me financimet terroriste gjate vitit 2005. Nga keto referime, jane iniciuar shtate urdhera ngrirje leshuar nga Ministri i Financave.

Vleresimi. Ne realitet, rezultatet operacionale te treguara me siper jane jo te orientuara. Kane ekzistuar disa faktore qe kane afektuar aftesine e NIF-it per tu performuar ne menyre eficiente dhe efektive.

**I pari faktor** ka qene mungesa e nje sistemi te kompjuterizuar te dhenash.

NIF-i shqiptar eshte nje nga te paktet njesi te inteligjences financiare ne bote pa nje baze te dhenash te kompjuterizuar per te procesuar dhe analizuar raportet e transaksioneve, vecanerisht duke marre parasysh faktin qe ka qene ne funksion qe prej pese vjetesh. Ne vitin 2003, OSBE pranoi te financonte pjeserisht zhvillimin e nje sistemi te dhenash te kompjuterizuar per NIF. Projekti kerkonte disa kohe dhe nje version BETA i bazes se te dhenave nuk u zhvillua deri ne veren e vitit 2005. Sidoqofte, hapa te tjere nuk jane ndermarre per te implementuar dhe zgjeruar qendren e te dhenave deri ne funksion te plote.

Mesatarisht NIF tashme merr 3500 RTV dhe RAD ne leter ne muaj, kryesisht nga institucionet financiare. Nje baze te dhenash ne funksion te plote do te lejoje qe informacioni nga cdo raport te kapet dhe te lidhet shpejt me cdo raport tjeter te lidhur me emrin e personit apo te entitetit ne fjale. Kjo lejon identifikimin e shpejte dhe analizen e modeleve te transaksioneve financiare. E paisur me kete aftesi analitike NIF mund te percaktoje qe transaksionet jane mjaftueshmerisht te dyshimta per te proceduar me investigim te metejshem.

Sidoqofte, per shkak te mungeses se nje baze te dhenash ne funksion te plote, ka qene nje akumulim punesh i pakapercyeshem dhe ne rritje prej mijera raporte transaksionesh deri ne mesin e vitit 2005. Raportet ishin ne kuptimin e vertete te fjales ne grumbuj me mbriritjen e tyre. Sasia e vertete e ngarkeses eshte e papercaktuar por ajo perfshin me shume se akumulimin e nje viti. Volumi absolut i raporteve mposhti kapacitetet e njesise per te kapur manualisht dhe perdorur ne kohe ndonje informacion qe mund te jete mbledhur nga raportet.

**Nje faktor i dyte** ka qene pamundesia per te shkëmbyer informacion me NIF e tjere. Ne Shtator 2004, NIF humbi lidhjen me website-in e grupit EGMONT per shkak te networkut te pasigurte te Ministrise se Financave. EGMONT eshte shoqata boterore e njesive te inteligjences financiare. Website-i i saj eshte i vetmi mjet per komunikim te sigurte dhe shkembimin e infoormacionit midis njesive.

Networku nuk takonte standardet e sigurise se kerkuar per te siguruar qe aksesit per informacionin te ishte i limituar vetem per personelin e NIF. Si rezultat, EGMONT nuk mundi te mbante lidhjen. Kjo mungese lidhjeje pengoi NIF-in shqiptar te shkembente dhe ndante inteligjencen me njesite e tjera gjate kesaj periudhe. Lidhja tashme eshte vendosur qysh ne Nentor 2005.




**Nje faktor i trete** ishte mosvazhdimesia operationale e NIF-it per pjesen kryesore te vitit 2005. Ndonese ndryshimi ne Drejtori te Pergjithshme nenkuptoi dhenien NIF te nje pavaresie me te madhe dhe pergjegjesi me te gjera operationale, vonesa ne implementim pati pothuaj efektin e kundert. Si rezultat i ndryshimit, nepunesit ekzistues ishin realisht te pa zene ne pune. Per shkak se stafi ishte i pasigurte per vazhdimesine e punesimit, shume prej tyre pushuan se kryeri funksionet e tyre. Ne fakt, shumica e rezultateve te arritura nga NIF gjate vitit 2005 jane permbushur gjate gjysmes se dyte te ketij viti.

**Se katerti**, ka ekzistuar nje mungese integrimi me institucionet e tjera qeveritare. Per shembull, bashkepunimi me Zyren e Rregjistrimit te Pasurive te Paluejtshme ka qene me teper formal se sa nje marreveshje pune. E njejta gje mund te thuhet ne lidhje me aspektet e pastrimit te parase per personat e ekspozuar politikisht; nuk ka pasur nje kooperim midis NIF dhe Inspektoriatit te larte te Deklarimit she Kontrollit te Pasurive

## 2.2 Organizimi strukturor dhe organizimi i punes ne DPPPP

Struktura organizative tashme numeron 22 nepunes civile me background kryesisht nga fushat e finances dhe jurisprudences te cilet punojne sipas kesaj strukture organizative.



Dy shtyllat kryesore te DPPPP jane Drejtorja e Inspektimit dhe Drejtorja e Analizes se informacionit financiar.

Drejtoria e inspektimit ushtron funksionet mbikqyrese dhe parandaluese per te mos lejuar perdorimin e kanaleve bankare dhe institucioneve te tjera financiare per qarkullimin e te ardhurave qe burojne nga veprimtari kriminale per te mundesuar pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit nepermjet ushtrimit te kontrolleve ne subjektet e ligjit, ngrirjen e asetave, llogarive bankare dhe marjen e masave administrative. Gjithashtu, kjo Drejtori eshte pergjegjese per koordinimin e shkembimit te inteligjences financiare me njesite homologe ne bote

Drejtoria e Analizes dhe Informacionit lehteson marrjen e pavarur te dokumentacioneve origjinale dhe analizen e raporteve te vlerave (RTV) dhe te raporteve te aktivitetit te dyshimte (RAD) nga subjektet raportuese ne nje hapesire te ndare dhe te kontrolluar fizikisht per sejcilin prej llojeve te raporteve. Gjate procesit te monitorimit dhe analizes raportet do te tregojne qartas nese kemi kemi te bejme me nje RTV apo nje RAD, sikurse do te beje dallimin midis pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit. Kjo drejtori ka pergjegjesine edhe per analizen strategjike mbi prirjet, modelet dhe tendencat, lidhur me pastrimin e parave apo financimin potencial te terrorizmit ne Shqiperi.

Brenda struktures organizative te DPPP funksionon Sektori i Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve, fokusi i te cilit eshte rekrutimi i punonjesve, trajnimi dhe asistenca teknike, zbatimi dhe koordinimi i parimeve dhe politikave dhe te menaxhimit te burimeve njerezore, te operacioneve te punes si dhe mundesimi i sherbimeve per te facilituar veprimtarite operacionale te dy Drejtorive kryesore.

Drejtoria e Pergjitheshme e Parandalimit te Pastrimit te Parave (DPPPP) eshte Njesia e Inteligjences Financiare e Shqiperise e cila eshte pergjegjese per marrjen, analizimin dhe shperndarjen e informacionit financiar te Agjensite e zbatimit te ligjit, informacion i cili lidhet me precedentet e veprimtarive kriminale te pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit.

NIF u krijua si nderlidhese ndermjet institucioneve financiare, komunitetit te biznesit me agjensite e zbatimit te ligjit dhe per te drejtuar e koordinuar luften kunder pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit. Pergjegjesite e saj fillojne qysh me detyrimin e subjekteve raportuese per te identifikuar klientin, perfituesin, regjistruar e ruajtur te dhenat, raportuar transakcionet e dyshimta (RAD) dhe ato te vleres mbi pragun e percaktuar ne ligj (RTV), monitorimin dhe analizen e ketij informacioni dhe shperndarjen sipas nje formati te percaktuar Agjensive te zbatimit te ligjit.

**Misioni i NIF-t eshte :** « Te punojme me partneret tane kombetare dhe nderkombetare per te zbuluar dhe goditur fenomenet e pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit »

Inteligjenca financiare ka te beje me perfundimin e rezultatit te analizimit nga nje ose disa raporte te lidhura te cilat DPPPP ka per detyre ti marre nga subjektet e ligjit apo edhe nga burime te tjera.

Njesia e Inteligjences Financiare, si Agjensi Qendrore Kombetare, ka pergjegjesine per te marre, kerkuar, analizuar dhe shperndare autoriteteve kompetente, zbulimin ose ekspozene e informacionit financiare lidhur me :

- te ardhurat qe dyshohen se kane origjine kriminale;
- kerkesat e bera nga entet rregullatore dhe licensuese kur ka rrethana te pazakonta dhe te pajustificuara mbi te cilat nje entitet i ri formohet apo kryen veprimtarine operacionale.

Institucionet financiare kane detyrimin ligjor per te identifikuar klientin, regjistruar e ruajtuar te dhenat, raportuar transaksionet e dyshimta (RAD) dhe ato mbi kufirin e vleres 20 milion leke (RTV). Keto institucione kane ngritur strukturat e tyre me persona pergjegjes ne kete drejtim dhe kane krijuar qendren e te dhenave.

Per te zbatuar pergjegjesite, NIF strukturon mbledhjen e informacionit qe perdoret per te identifikuar pastrimin e parave/financimin e terrorizmit dhe aktivitetet e tjera kriminale. Vec subjekteve te percaktuar ne ligj, NIF mbledh te dhena dhe nga burime te tjera sic jane agjensite e zbatimit te ligjit (policia, prokuroria), autoritete te tjera rregullatore dhe cdo njesi tjeter qe mund te jete burim i dobishem informacioni financiar.

NIF shkemben inteligjencen financiare edhe me njesite homologe ne bote. Ky rol luhet nga Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te Pastrimit te Parave si anetare e Grupit EGMONT qe eshte forum me i madh nderkombetar per te realizuar bashkepunimin ne zonat e shkembimit te informacionit, trajnimit dhe te ndarjes se eksperiences. NIF eshte i ngarkuar jo vetem me luften kunder pastrimit te parave por edhe ne luften kunder financimit te terrorizmit. Ky funksion mbeshetet nga ligji **Nr.9258, date 15/07/2004 "Per masat kunder financimit te terrorizmit"** i cili krijon mbeshetjen ligjore per parandalimin e perdorimit te fondeve qe burojne nga veprimtaria kriminale per financimin e mundshem te terrorizmit.

Nga ana tjeter organet investigative dhe ato te procedimit, kerkojne nga NIF informacionet e nevojshme per cdo rast apo person qe investigohet prej tyre per pastrim parash apo financim te terrorizmit.

Me riorganizimin e NIF-it ne nivel Drejtorie te Pergjithshme jane shtuar edhe funksionet inspektuese, gje qe mundeson kontrollet mbikqyrese dhe parandaluese "on-site" ne subjektet raportuese ne konformitet me kerkesat e ligjit.

Objektivi i NIF-it ne kete drejtim synon te ndihmoje subjektet raportuese per identifikimin e treguesve dhe sektoreve potencialisht vulnerabel te pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit si dhe inicimit te perpilimit te raporteve te transaksioneve te dyshimta sipas formatit te miratuar nga NIF.

Rezultatet e NIF-it shqiptar janë prove e pakundershtueshme e angazhimit të Shqipërisë si pjesëtarë aktive e koalicionit ndërkombëtar për të parandaluar pastrimin e parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit.

Në përputhje të plotë me kërkesat e programit të Qeverisë, do të jetë akoma më e fuqishme lufta kundër krimit të organizuar, trafikimit në pëërgjithësi dhe veçanërisht drogave dhe qënieve njerëzore, po ashtu edhe lufta kundër pastrimit të parave që burojnë nga aktivitetet kriminale të lart përmendura. Në këtë këndvështrim, në Kodin e Procedurës Penale janë parashtruar disa amendamente në lidhje me dënimet maksimale dhe ato të përcaktuara qartë për këto aktivitete kriminale.

Shqipëria do të përmbushë në mënyrë aktive dhe me përkushtim të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë në lidhje me luftën finale kundër terrorizmit si rreziku dhe armiku numër një i paqes, sigurisë dhe jetës së njerëzve.

Shqipëria e ka vlerësuar dhe i ka kushtuar një vëmendje të veçantë edhe aspektit legjislativ që ka të bëjë me mbylljen e të gjitha hapësirave legale për të krijuar një ambient asfiksues për veprimtaritë kriminale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Shqipëria ka treguar një kujdes të veçantë edhe në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Evropës për vlerësimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave, të 40 + 9 rekomandimeve speciale të FATF-se si dhe nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin e konventave ndërkombëtare të Strasburgut, Vjenës, Palermos etj që kanë lidhje me luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikëve të ndyshme.

Parlamenti Shqiptar me ligjin 9084, datë 19.06.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave" realizoi disa përmirësime shumë cilësore që konsistojnë në :

- një rikonceptim të perkufizimit të pastrimit të parave në të cilin përfshihet edhe koncepti i produkteve e perfitimeve të ardhura nga veprimtaria kriminale;
- rishikimin e raportimit të shumës limit të transaksioneve të vlerave;
- rikonceptimin e plotë të detyrave të "Autoritetit përgjegjës"(NIF);
- vendosjen e kufizimeve dhe kontrollin me të forhtë për levizjen e monedhës cash në pikat e kalimit kufitar;
- ndalimin me ligj të çeljes së llogarive anonime ose nën emra fiktive ;
- rishikimin e sanksioneve administrative ndaj subjekteve raportuese;
- detyrimin e subjekteve për të raportuar rastet dyshimesh të bazuara për produkte të destinuara për financimin e terrorizmit ;
- rishikimin e listës së subjekteve që raportojnë transaksione të dyshimta, duke përfshirë OJF dhe bizneset e ndërtimit ;

- ngritjen e Komitetit Kombetar te Bashkerendimit te Luftes Kunder Pastrimit te Parave i cili percakton drejtimet e politikes se pergjithshme shteterore ne fushen e parandalimit te pastrimit te parave etj.

Krahas miratimit te ndryshimeve qe ju bene Ligjit per Parandalimin e Pastrimit te Parave, nga Parlamenti Shqiptar u miratuan edhe permiresimet ne ligjin nr. 9086, date 19.06.2003 Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 7895, date 27.01.1995 “Kodi penal i Republikes se Shqiperise”, te cilat konsistojne ne :

- zgjerimin e games se vepres penale te pastrimit te parave sipas nenit 287 te ketij ligji, ku pastrimi i produkteve te vepres penale i cili kryhet sipas germave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” denohet me burgim nga tre deri ne dhjete vjet dhe me gjobe nga 500 mije deri ne 5 milion leke;
- penalizimin e strukturimit te transakcioneve per te shmangur detyrimin per raportim;
- penalizimin e çeljes se llogarive anonime ose nen emra fiktive, te cilat denohet me burgim deri ne tre vjet dhe me gjobe nga 200 mije leke deri ne 2 milion leke;
- penalizimin e kalimit ilegal te cash-it ne kufi mbi shumat 1 milion leke apo kundervleften me monedha te huaja, instrumentave te tjere te negociushem, sendeve me vlere dhe atyre antike, kur perbejne veper penale denohen me gjobe ose me burgim deri ne dy vjet;
- penalizimin e financimit te terrorizmit ose mbeshtetja ne çdo forme e tij, denohen me burgim jo me pak se pesembedhjete vjet deri ne burgim te perjetshem dhe me gjobe nga 5 milion deri ne 10 milion leke.

Permiresime jane reflektuar edhe kodin e procedures penale me ane te Ligjit nr. 9085, date 19.06.2003 per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 7905, date 23.03.1995 “ Kodi i Procedures Penale te Republikes se Shqiperise” te cilat konsistojne ne :

- permiresimin e rregjimit te konfiskimit te te gjitha fitimeve qe rrjedhin nga veprimtaria kriminale;
- konfiskimin e fitimeve jo te drejtperdrejta te veprimtarive kriminale, aseteve zevendesuese dhe te krimeve te perziera.

Me ligjin nr. 9258, date 15.07.2004 ‘Per masat kunder financimit te terrorizmit ‘ u synua qe te parandalohen veprimtarite dhe te goditen subjektet terroriste dhe ato qe mbeshtetin dhe financojne terrorizmin, duke bllokuar dhe sekuestruar fondet dhe pasurite e tyre, sipas rezolutave perkatese te Keshillit te Sigurimit te Kombeve te Bashkuara, akteve te organizatave te tjera nderkombetare e marreveshjeve nderkombetare ku Republika e Shqiperise eshte pale.

Miratimi i ligjit nr. 9284, date 30.09.2004, ‘Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar’, krijon nje baze solide per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar nepermjet zbulimit, identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit te pasurive te paligjshme te personave te dyshuar si pjesemarres ne krimin e organizuar si dhe percaktimin e menyres se perdorimit te ketyre pasurive.

Me vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 503, date 30.06.2005 “Per organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjensise per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara”, u vendos qe kjo njesi te organizohet si institucion buxhetor ne varesi te Ministrit te Financave. Kjo agjensi merr masat e nevojshme per administrimin e fondeve dhe pasurive te sekuestruara dhe te konfiskuara, te personave te dyshuar apo te shpalluar si pjesmarres ne krimin e organizuar, sipas vendimeve gjyqesore te formes se prere, rezolutave te Keshillit te Sigurimit si dhe detyrimeve qe burojne nga kerkesat e ligjit “Per masat kunder financimit te terrorizmit”.

Ngjarjet e 11 Shtatorit 2001 ishin nje faktor qe nxiten marrjen e nje sere masash kunder terrorizmit dhe financimit te tij nga autoritet shteterore te te gjitha vendeve.

Parlamenti Shqiptar menjehere mori nje vendim te posaçem nr. 7 date 15.10.2001, ne te cilin Shqiperia perfshihet si aleate ne luften kunder terrorizmit nderkombetar. Ky vendim percaktoi nje sere detyrimesh konkrete per te gjitha institucionet vendase ne drejtim te masave kunder financimit te terrorizmit, per verifikimin, identifikimin dhe ngrirjen e llogarive bankare e aseteve te te implikuarve ne financime terroriste.

Keshilli i Ministrave i Republikes se Shqiperise ne kete kendveshtrim hartoi, miratoi dhe zbatoi Planin Kombetar te Veprimit Kunder Terrorizmit me Vendimin nr.12 date 28.01.2001. Ne kete vendim jane percaktuar qarte detyrimet perkatese per te gjitha institucionet e vendit per verifikimin, bllokimin dhe ngrirjen e llogarive bankare e te pasurive personale te te implikuarve ne financimet terroriste.

Eshte treguar kujdes ne lidhje me zbatimin e 40 rekomandimeve te FATF-s dhe 9 rekomandimeve speciale shtese per identifikimin, bllokimin dhe sekuestrimin e pasurive dhe te fondeve te grumbulluara ose te destinuara per financim te terrorizmit nderkombetar.

Nga viti 1994 ne vendin tone u vendosen disa fondacione kryesisht islamike, organizma private te rregjistruara si entitete per propogandimin e fese islame dhe ndihmesen e disa shtresave vulnerable te shoqerise shqiptare.

Keto organizata private kane shtrire aktivitetin e tyre per nje kohe te shkurter ne shume qytete te vendit dhe hapen llogari bankare ne disa banka te nivelit te dyte ne emer te administratoreve si dhe realizuan disa transferta brenda dhe jashte vendit, ku ne as nje rast nuk rezulton burimi i te ardhurave, perfituesi perfundimtar si dhe destinacioni i perdorimit te ketyre fondeve.

Pervec objektivave te deklaruar ne status, rezultoi nga listat e shpallura se disa prej tyre ishin implikuar edhe ne perzgjedhjen dhe stervitjen e muxhahidineve ne Bosnje, Çeçeni, Kosove etj. si dhe kane sherbyer si mbeshtetes te rrjetit terrorist Al- Qaeda e sidomos ne trafikun nderkombetar te armeve ne favor te ketij rrjeti.

Shqiperia si pjestare ne luften globale kunder financimit te terrorizmit ka nenshkuar, ratifikuar dhe zbaton te gjitha konventat nderkombetare qe kane lidhje me luften kunder te gjitha krimeve dhe trafikëve te paligjshme.

Ne zbatim te ligjit nr.9258 date 15.07.2004. "Per masat kunder financimit te terrorizmit", nga Ministria e Financave u hartua dhe me pas nga Keshilli i Ministrave u miratua Vendimi nr.718 date 29.10.2004 "Per listen e personave te shpallur si financues te terrorizimit". Mbi kete baze nga verifikimet me subjektet e ligjit jane pergatiur, nxjerre dhe botuar ne fletore zyrtare tete urdhera sekuestrimi.

NIF shqiptar, pervec detyrimeve te legjislacionit vendas ka zbatuar edhe detyrimet e percaktuara ne Rezolutat e Keshillit te Sigurimit te Kombeve te Bashkuara.

Mbi kete baze DPPP (NIF) ka intensifikuar punen ne drejtim te verifikimit nga subjektet e ligjit te personave te implikuar ne organizatat terroriste dhe kryesisht ne organizaten Al- Qaeda e kryesuar nga terroristi Osama bin Laden.

Jane verifikuar 73 lista te personave te implikuar ne financimet terroriste me subjektet e ligjit e kryesisht me bankat e nivelit te dyte e jane marre rreth 70 informacione e raporte per implikime e dyshime per lidhje ne financimin e terrorizmit.

## **2.3 VLERESIMI I BUXHETIT PER VITIN 2006**

### **2.3.1 Buxheti i kërkuar**

Ne zbatim te Ligjit te permiresuar te Parandalimit te Pastrimit te Parave dhe me vendim te Keshillit te Ministrave nr. 108, date 11.02.2005, DBLKPP eshte ngritur ne nje nivel me te larte dhe funksionon si Drejtori e pergjithshme. Ky organizim ka ndikuar ne rritjen e pavaresise operationale dhe asaj buxhetore si dhe shtimin e funksioneve inspektuese te kesaj strukture.

Objektivat e ketij institucioni ne luften per parandalimin e pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit ne perputhje me legjislacionin vendas dhe stadartet nderkombetare te ratifikuara me ligj, domosdoshmerisht kerkojne qe ky institucion te kete ne dispozicion dhe te administroje buxhetin e vet per te permbushur detyrimet.

Nevojat tona te parashikuara ne projekt-buxhetin e vitit 2006 diktohen nga:

- Kalimi i Drejtorise me pavaresi operationale dhe buxhetore.
- Infrastruktura ne dispozicion e trashëguar nga Drejtoria e Bashkerendimit te Luftes Kunder Pastrimit dhe Parandalimit te Parave ne Ministrine e Financave.

- Zgjerimi dhe zhvillimi i stafit nga 10 ne 22 punonjes, shtimi i disa funksioneve te tjera te inspektimit ne subjektet raportuese, menaxhimit te burimeve njerezore, finances dhe administrimit.
- Ambientet e reja te vena ne dispozicion te Drejtorise te rikonstruktura me fonde te Bashkimit Europian nen Programin "Cards".
- Ndertimi i arkitektures se Teknologjise se Informacionit, ngritja e zhvillimi i nje qendre te dhenash bashkekohore, sigurimi, implementimi i programeve software analitike.
- Permbushja e detyrimeve ligjore vendase qe lidhen me luften kunder pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit dhe marreveshjeve nderkombetare te ratifikuara me ligj.

### 2.3.2 Buxheti i akorduar

Per vitin 2006 shpenzimet parashikohen te jene rreth 55,000 mije leke te fokusuara ne keto drejtime:

- |                           |                  |
|---------------------------|------------------|
| • Pagat                   | 22,000 mije leke |
| • Sigurime shoqerore      | 6,000 mije leke  |
| • Shpenzime korrente      | 12,000 mije leke |
| • Shpenzime per investime | 15,000 mije leke |

Shpenzimet per investime te parashikuara ne vleren 15,000 mije leke do te kryhen ne keto drejtime:

- Per ndertimin e ambjenteve te nje kati shtese mbi Drejtorine e Inspektimit, 260 m<sup>2</sup> ndertim me nje vlere prej 9,550 mije leke e cila perfshine 450 mije leke shpenzime projekti dhe 9,100 mije leke shpenzime ndertimi 260 m x 35 mije leke/m<sup>2</sup>.
- Shpenzime per blerjen e nje skaneri (high speed) profesional i cili do te sherbeje per te kaluar ne bazen e te dhenave ne forme elektronike te gjitha raportet e grumbulluara deri tani ne Drejtorine tone, ne vleren 1,250 mije leke.
- Paisje te tjera "hardware" per plotesimin e nevojave kryesore te stafit ne vleren 2,500 mije leke.
- Shpenzime per trajnim personeli, per pergatitje broshura, spote dhe mesazhe promocionale per ndergjegjesimin e publikut ne vleren 1,700 mije leke.

### 2.3.3 Analiza e shpenzimeve kundrejt buxhetit

Gjate vitit 2005 shpenzimet per funksionimin e administrates se DPPPP ishin ne vleren e 10,520 mije leke, nderkohe qe shpenzimet e parashikuara per vitin 2005 ishin ne vleren 13,800 mije leke.



Struktura e shpenzimeve (ne mije leke) te kryera per nevoja te DPPP-se ka qene si me poshte :

<u>Shpenzimet</u>	<u>Te kryera (000leke)</u>	<u>Te parashikuara(000leke)</u>
Pagat	3,004	4,000
Sigurimet	728	1,500
Shpenzime korente	1,573	3,000
Shpenzime per investime	5,214	5,300

### **2.3.4 Financime nga donatoret dhe asistenca teknike e huaj**

Departamenti Amerikan i Thesarit ka dhene asistencë teknike të vazhdueshme që nga ngritja e NIF nëpërmjet atashimit prane kesaj strukture te nje këshilltari teknik rezident.

Bashkimi Evropian nëpërmjet Programi CARDS ka ndihmuar ne rikostruksionin e godines re dhe ne trainime per personelin e NIF

Komiteti MONEYVAL i keshillit te Europes ka asistuar si monitorues per vleresimin e masave dhe nevojave kunder pastrimit te parave ne Shqiperi.

FMN ka dhene asistencë teknike ne rishikimin e legjislacionit dhe sistemit të masave kundër pastrimit të parave në vendin tonë si dhe ne paketa trainimesh e kualifikimesh te vazhdueshme.

OSCE në Tiranë ka ndihmuar në organizimin e Konferences I-rë Rajonale të NIF dhe në dizejnimin e një softi elektronik te dhenash.

Banka Boterore dhe FCV ka ndihmuar ne trainime dhe vizita studimore.

## **2.4 NDERVEPRIMI INSTITUCIONAL**

Eksperiencia e NIF-t Shqiptar dhe ajo e strukturave homologe te vendeve me te zhvilluara ka treguar se lufta fragmentare dhe veprimet e shkeputura ne fushen e parandalimit te pastrimit te parave dhe luftes kunder financimit te terrorizmit nuk japin rezultatet e duhura.

Ne vitin 2002, NIF shqiptar inicioi nenshkrimin e Memorandumit te Mirekuptimit "Mbi bashkepunimin nderinstitucional per luften kunder pastrimit te parave" ne te cilin perfshiheshin Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Prokuroria e Pergjithshme, Banka e Shqiperise dhe Sherbimi Informativ Shteteror.

Me permiresimet qe ju bene ligjit per parandalimin e pastrimit te parave u be i mundur dhe krijimi i Komitetit Kombetar te Bashkerendimit te Luftes Kunder

Pastrimit te Parave i cili drejtohet nga Kryeministri dhe ne perberje te te cilit jane edhe Prokurori i Pergjithshem, Guvernatori i Bankes se Shqiperise, Ministri i Puneve te Jashtme, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshem, Ministri i Drejtesise dhe Kryetari i Sherbimit Informativ.

Detyra e ketij komiteti eshte percaktimi i politikës se pergjithshme shteterore ne fushen parandalimit te pastrimit te parave. Ne Komitet shqyrtohen dhe analizohen raportet e veprimtarise se NIF-t si dhe raporte e dokumenta te pergatitura nga institucione nderkombetare, qe ushtrojne veprimtari ne fushen e parandalimit te pastrimit te parave dhe ne luften kunder financimit te terrorizmit. Ne kete Komitet diskutohen dhe çeshtje te tjera te rendesishme qe çmohen nga Kryeministri, Prokurori i Pergjithshem dhe Guvernatori i Bankes se Shqiperise.

Ne mbledhjen e Komitetit mund te thirren per te mare pjese, ministra, deputete, drejtues te institucioneve si dhe specialiste te fushes se parandalimit te pastrimit te parave dhe luftes kunder financimit te terrorizmit.

Rregullat e hollesishme per organizimin dhe funksionimin e ketij komiteti jane miratuar ne rregulloren "Per funksionimin e Komitetit Kombetar te Bashkerendimit te Luftes Kunder Pastrimit te Parave" te miratuar nga ky komitet me 23.03.2004.

Ne rregulloren e funksionimit te komitetit eshte miratuar ngritja dhe funksionimi i Grupit Teknik Nderinstitutional te Punes per parandalimin e pastrimit te parave, ku drejtori i NIF-t eshte kryetar i ketij grupi.

Grupi teknik ka si objekt te veprimtarise se tij koordinimin e punes me institucionet publike te cilat jane te perfshira ne parandalimin e pastrimit te parave dhe luften kunder financimit te terrorizmit. Ky grup harton dhe zbaton programe te detajuara veprimesh per bashkepunimin nderinstitutional.

Duke patur parasysh se Shqipëria vazhdon te jete nje ekonomi gjerësisht e bazuar ne perdorimin e cash-it, kjo përfaqëson një sfidë thelbësore për zbatimin e masave efektive të parandalimit te pastrimit te parave dhe luftes kunder financimit te terrorizmit.

Per sa me siper nevojitet gjetja e nje balance midis aplikimit te masave të parandalimit te pastrimit te parave dhe luftes kunder financimit te terrorizmit në përputhje me standartet ndërkombëtare nga njera ane dhe thellimit te reformave kunder ekonomise informale nga ana tjeter.

Gjithashtu nisma e Ministrise se Financave për të inkurajuar përdorim ne shkalle te gjere të sistemit bankar per te gjitha institucionet publike eshte nje nga faktoret jetike per minimizimin e qarkullimit te cash-it dhe pasojave qe burojne prej tij .

Ne kete kuader persa i takon detyrave dhe planeve te perbashketa qe jane hartuar me strukturat e tjera te luftes kunder PP dhe FT siç jane Ministria e Brendshme, Sherbimi Informativ, Banka e Shqiperise, Prokuroria e Pergjithshme etj, situata paraqitet si me poshte:

- Eshte hartuar **Urdheri i perbashket nr.13, date 8.04.2005** (i Ministrit te Financave, Ministrit Brendshem, Ministrit te Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Kryetarit te Sherbimi Informativ Shteteror) **“Per marjen e masave per ndalimin e kembimit ilegal valutor”** se bashku me planin e veprimeve per ndalimin dhe mbylljen e aktivitetit te paligjshem te kembimit valutor.
- Eshte hartuar draft-programi kombetar **per kontrollin e levizjes se monedhes ne cash ne pikat e kalimit kufitar ne Republiken e Shqiperise**, ku per çdo institucion jane pershkruar detyrat e tij konkrete.

#### **2.4.1 Mbledhje te organizuara midis institucioneve**

Ne Grupin Teknik Nderinstitucional per Parandalimin e Pastrimit te Parave dhe luftes kunder financimit te terrorizmit jane diskutuar kryesisht keto probleme :

- hapat qe duhet te ndermarrin institucionet shtetore per kontrollin e levizjes se monedhes cash dhe parandalimin e perdorimit te saj jashte sistemit bankar.
- rishikimi i bazeve aktuale ligjore per kontrollin e monedhes cash, duke permiresuar dhe legjislacionin bankar, kodin doganor dhe ate tatimor;
- rritja dhe forcimi i bashkepunimit ndermjet strukturave te Bankes se Shqiperise, Policise se Shtetit, Sherbimit Informativ, Organeve Tatimore, Organeve Doganore, Ministrise se Drejtesise dhe Drejtorise se Pergjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave;
- Due diligence nga subjektet raportuese per personat e ekspozuar politikisht;
- Bashkepunim me i ngushte ndermjet institucioneve per te patur akses ne te dhenat e levizjes se udhetareve dhe te automjeteve (Policia, Prokuroria ka ne dispozicion programin TIMS);
- Ndjekja e te gjitha rasteve te dyshuara dhe koordinimi i puneve midis institucioneve te involvuara ne keto raste.

#### **2.4.2 Raporte te dhena**

Ne zyren e Prokurorit, referohen ato raste që kanë elemente të mjaftueshem të dyshimit të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, si dhe elemente komprometuese ose të provave për të filluar një procedim penal ose investigim të metejshëm.

Ne Policine Kriminale, (Drejtore e Luftes Kunder Krimin te Organizuar) ne Ministrine e Brendshme, referohen ato raste që kanë nevojë për investigim policor dhe kompletimin me elemente të tjere para se ti kalojne Prokurorise per ndjekje penale. Pas përfundimit të investigimit policor, kallezimi në organin e prokurorise mund të behet prej policise duke njoftuar Autoritetin Pergjegjes (NIF) ose nepermjet ketij te fundit pa perjashtuar edhe rastin e referimit te perbashket.

Disa të dhena statistikore për vitin 2005 dhe progresiv nga themelimi i njesise:

Nr.	Pershkrimi	Viti 2005	5 vitet (2001- 2005)
1	Derguar ne polici per investigim	10	41
2	Kallzim ne prokurori	11	21
	- per pastrim parash	4	12
	- financim terrorizmi	7	9
3	Te denuar (pastrim parash)		5
4	Ne gjykim		1
5	Masa te marra :		
	1.Urdhera ngrirje (asete, pasuri, investime) nga keto :	7	8
	- Pastrim parash	0	0
	-Financim terrorizmi	7	8
6	2. Llogari bankare te ngrira	12	63
	- Pastrim parash	0	2
	- Financim terrorizmi	12	61

Ne Zyren e Prokurorit te Pergjithshem, per peirudhen 2001-2005, jane bere 9 kallezime per ndjekje penale per implikime ne financimet terroriste. Nga keto rezultojne te implikuar;

- 12 kompani;
- 5 fondacione islamike;
- 4 individe

Jane ngrire 63 llogari bankare, vlera e te cilave u korespondon shumave ne **2.136.226 Euro, 1.814.703 USD dhe 4.116.438 leke.**

Nga keto :

- Per financim terrorizmi jane ngrire 61 llogari bankare vlera e te cilave u korespondon shumave ne 2,136.226 Euro, 313,161 Usd dhe 3,560,169 Leke.
- Per pastrim parash jane ngrire 2 llogari bankare vlera e te cilave u korespondon shumave ne 1,501,542 Usd dhe 556,269 Leke.

Jane sekuestruar pasuri te paluajtshme, 23 apartamente banimi me sipërfaqe 2,429 m2 dhe sipërfaqe trualli 17,060 m2

### 2.4.3 Raporte te marra

Ne zbatim te ligjit per parandalimin e pastrimit te parave subjektet e tij jane te detyruara ti japin informacion NIF -t si me poshte:

1. Subjektet raportuese sipas nenit 3 te ligjit raportojne per çdo dyshim per pastrim parash dhe per veprime financiare mbi shumen e 20 milion lekeve.
2. Organet doganore sipas nenit 10 te ligjit, raportojne per çdo transakcion te aktivitetit te dyshimte (RAD) dhe ne pikat e kalimit kufitar per shumat ne cash te udhetareve, mbi 1 milion leke.
3. Organet tatimore sipas nenit 10/1 te ligjit, raportojne per çdo transakcion te aktiviteve te dyshimta (RAD).
4. Organet qe licensojne personat fizike dhe juridike sipas nenit 10/2 te ligjit, raportojne per cdo dyshim per pastrim parash dhe per veprime financiare mbi vleren e 20 milion lekeve.

Nr	PERSHKRIMI	Raporte te marra	Raporte te dhena
1	RTV	26869	-
2	RAD:	121	91

## 2.5 NDERVEPRIMI ME SUBJEKTET RAPORTUESE

### 2.5.1 Zhvillime

Parandalimi i mosperdorimit te kanaleve te institucioneve financiare nga pastruesit e parave dhe financuesit potenciale te terrorizmit arrihet permes zbatimit te ligjit prej subjekteve raportuese te kerkesave per raportimin e transakcioneve financiare ose atyre te aktivitetit te dyshimte tek Autoriteti pergjegjes (NIF).

Per kete qellim çdo subjekt raportues sipas industrise qe perfaqeson, miraton procedurat dhe rregulloret ne perputhje me ligjin te cilat konsistojne ne :

- miratimin e standarteve te brendshme per identifikimin e klienteve;
- caktimin e personave apo njesive pergjegjese per raportimin e menjehershem tek NIF te RTV-ve dhe RAD-ve;
- RTV-te dorezohen tek NIF nga subjekti raporues per çdo transakcion qe kalon pragun e miratuar ne ligj;
- RAD-te dorezohen tek NIF nga subjektet raportuese per te gjitha aktivitetet e dyshimta, pavaresisht nga vlera e involvuar ne transakcion.

## 2.5.2 Raporte te marra nga subjekti raportues

Subjektet raportuese informojne menjehere NIF-n perpara kryerjes se transaksionit, kur ato kane informacione ose dyshime se nje transaksion ka si burim, rrjedh, perdoret ose synon te perdoret per te rritur mbeshitetjen, lehtesuar, mbrojtur, nxitur, fshehur aktet terroriste, financimin e terrorizmit ose kryerjen e veprave te tjera penale ne fushen e ekonomise.

Disa te dhena statistikore per raporte te marra nga subjektet raportuese per vitin 2005 jepen ne pasqyren me poshte

### Raporte te marra nga NIF :

<b>Nr</b>	<b>PERSHKRIMI</b>	<b>RTV</b>	<b>RAD</b>
2.1	Bankat	26,746	6
2.2	Institucione te tjera	123	21
2.3	Ministria e Brendshme		18
2.4	Tatimet		16
2.5	Doganat		33
2.6	Homologet		14
2.7	ZRPP		13
	<b>TOTALI</b>	<b>26,869</b>	<b>121</b>

### 2.5.3 Raporte te derguara nga NIF-i tek institucione te tjera :

<b>Nr</b>	<b>PERSHKRIMI</b>	<b>RTV</b>
2.1	Prokuroria	<b>11</b>
	5 Financim terrorizmi	7
	6 Pastrim parash	4
2.3	Ministria e Brendshme	<b>10</b>
2.4	Tatimet	<b>43</b>
2.5	Doganat	<b>11</b>
2.6	Homologet	<b>16</b>
2.7	ZRPP	-
	<b>TOTALI</b>	<b>91</b>

### 2.5.4 Gjoha administrative te vendosura per mosrespektim te ligjit, numri i rasteve, vlera dhe sasia sipas monedhes.

Me riorganizimin e NIF-t është shtuar edhe kompetenca e inspektimeve në vend (on-site), gje e cila e bën përgjegjëse këto struktura për identifikimin dhe zhvillimin e subjekteve raportuese sipas kërkesave të ligjit për fillimin e raportimit.

Objektivat e NIF-t në këto drejtim janë fokusuar në zhvillimin e subjekteve raportues që të iniciojnë dorëzimin e raporteve të transaksioneve të vlerave (RTV) dhe raporteve të aktiviteteve të dyshimta (RAD). Këto po e realizojmë nëpërmjet planifikimit, të zbatimit të inspektimit në vend dhe plotësimit të raportit të inspektimit.

Për këto periudha të shkurtra që nga riorganizimi i NIF-t janë kryer 13 inspektime kryesisht në shoqëritë e sigurimeve dhe në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Gjate kryerjes së inspektimeve në subjekte janë vënë re mangësi në zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore.

Për këto qëllim nga NIF janë propozuar për tu gjëbatur për kundravajtje administrative 5 subjekte dhe 4 persona përgjegjës në vlerën e 680 mijë lekeve, për të cilat po ndiqen procedurat e nevojshme ligjore.

### **2.5.5 Ndergjegjesimi i publikut.**

Bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj dhe në legjislacionin vendas, DPPPP përfaqëson Agjencinë Qendrore Kombëtare, përgjegjëse, për marrjen, kerkimin, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritetet kompetente të informacionit financiar lidhur me dyshime për produkte të rrjedhura nga krimet dhe financimet potenciale të terrorizmit të kerkuara nga legjislacioni apo organet rregullatore për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin potencial të terrorizmit.

Në këto kuader me qëllim parandalimin dhe goditjen e fenomeneve të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit, synojmë :

- Që nëpërmjet institucioneve të involvuara në luftën kundër këtyre veprimtarive kriminale të përshejtojmë masat dhe të nxisim strukturat për një bashkëpunimin dhe bashkëveprim sa më të ngushtë **si dhe të ndergjegjsojmë publikun** kundër këtyre fenomeneve ;
- T'i bëhet e njohur publikut se mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë përtej vlerës së parashikuar në ligj përben kundravajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim deri në dy vjet;
- Duhet të ndermerren hapa për ndergjegjesimin e publikut për të minimizuar përdorimin e cash-it, për të eliminuar tregun informal valutash si dhe

kryerjen e transaksioneve te shitjeve dhe blerjeve nepermjet sistemit bankar.

Per kete, strukturat e DPPP jane te angazhuara te realizojne spote publicitare dhe mesazhe promocionale ne radio, tv si dhe te pregatisin broshura, fletpalosje, postera per te informuar publikun mbi pasojat negative qe sjell ne ekonomine e vendit kalimi ilegal i cash-it ne pikat e kalimit kufitar dhe qarkullimi i tij ne shkalle te gjere ne tregun informal valutor.

- Duhet te ndermerren hapa per perfshirjen ne procesin e raportimit te profesioneve te lira si notere, avokate, vleresues te pasurive, ekspertet dhe kontabilistet e miratuar.

Ne kete perspektive do te organizohen seminare, per njohjen dhe zbatimin e ligjit per parandalimin e pastrimit te parave dhe financimit kunder terrorizmit, me punonjesit e institucioneve te tilla si tatimet, doganat, bankat e nivelit te dyte, zyrat e hipotekes, zyrat e notereve, zyrat e avokateve, zyrat e vleresuesve te pasurive, institutin e eksperteve kontabel dhe shoqatat e kontabilisteve.

## 2.6 SHTOJCA E INFORMACIONIT STATISTIKOR

### 2.6.1 Raporte te marra dhe te dhena sipas sektoreve

Disa te dhena statistikore per raporte te dhena dhe te marra nga subjektet raportuese per vitin 2005 jepen ne pasqyren me poshte

Nr	PERSHKRIMI	RTV	RAD
1.a	Banka	26,746	6
1.b	Institucione te tjera jobankare	123	115
2.b	<b>TOTALI</b>	26869	121

### 2.6.2 Marreveshje nderkombetare te nenshkuara

Ne kuadrin e bashkepunimit reciprok per te ndihmuar ne investigimin dhe ndjekjen penale te personave te dyshuar per pastrim parash dhe financim terrorizmi, NIF shqiptar ka lidhur marreveshje bashkepunimi per mbledhjen, perpunimin e te dhenave dhe analizimin e informacionit me 24 NIF homologe. Per vitin 2005 FIU Shqiptar ka nenshkuar marreveshje bashkepunimi me 6 struktura



homologe siç janë: Sllovakia, Guatemala, Ukraina, Venezuela, Rumania dhe Bosnje & Hercegovina.

### **2.6.3 Marreveshje nderkombetare qe duhen nenshkruar**

FIU Shqiptar është duke bërë negociata për të nënshkruar marreveshje bashkepunimi me strukturën homologe AUSTRAC (Australi), FINCEN (USA) dhe atë të Moldavisë.

### **2.6.4 Kërkesa nderkombetare të marra dhe të dhëna midis NIF shqiptar dhe NIF homologe.**

NIF shqiptar në vijim të bashkepunimit me NIF-t homologe ka patur shkëmbime të frytshme të inteligjencës financiare në lidhje me persona apo kompani të cilat kanë shfrytëzuar biznesin ndërkombëtar për të humbur gjurmët e aktivitetit të tyre kriminal. Gjatë kësaj periudhe janë marrë nga NIF-t homologe 16 kërkesa për investigim nga ana jone të cilave u është kthyer përgjigje brenda afatit ose janë në proces, ndërkohë që njëkohësisht ka patur nga ana jone 14 kërkesa për informacion nga NIF-t homologe të cilave po ashtu ose u është dhënë përgjigje ose janë në proces elaborimi.

Bashkepunimi në këto kuader po forcohet gjithnjë e më shumë edhe si rezultat i memorandumëve dypalëshë të bashkepunimit të cilat po nënshkruhen mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera

### **2.6.5 Urdhër ngrirje sipas datës, numrit të llogarisë, emrit dhe sasisë.**

Në zbatim të Ligjit nr.9258 datë 15.07.2004. "Për masat kundër financimit të terrorizmit", nga Ministria e Financave u hartua e më pas nga Këshilli i Ministrave u miratua Vendimi nr.718 datë 29.10.2004 "Për listen e personave të shpallur si financues të terrorizimit". Mbi këto baze nga verifikimet me subjektet e ligjit janë përgatitur, nxjerre botuar në fletore zyrtare të urdhëra sekuestrimi të Ministrisë të Financave si :

- Urdhëri nr.2 datë 24.12.2004 "Për sekuestrimin e asteteve të shtetasit arab Yassin Kadi dhe të kompanive të lidhura me të" .
- Urdhëri nr.5 datë 10 .03.2005 "Për sekuestrimin e asteteve të shtetasit Nabil Abdul Sayadi",
- Urdhëri nr.6 datë 10.03.2005 "Për sekuestrimin e asteteve të shtetasit Patricia Rosa Vinck";
- Urdhëri nr.7 datë,10 .03.2005 "Për sekuestrimin e asteteve të fondacionit "Global Relief Foundation" (GRF)";

- Urdheri nr.8 datë 10 .03.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te fondacionit “Ringjallja e Trashëgimisë Islame”, e njohur dhe si “Revival Of Islamic Heritage Society”, RIHS”;
- Urdheri nr.9 datë 10.03.2005 “Per sekuestrimin e asteteve te fondacionit “Taibah of Islamic”, e njohur dhe si Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave”,
- Urdheri nr.10 datë 10.03.2005 “Per sekuestrimin e aseteve te Fondacionit "Al Haramania",
- Urdheri nr.6 date 25.11.2005 “Per sekuestrimin e aseteve te shtetasit jordanез Abdyl Latif Saleh, ne baze te vendimit (VKM) shtese nr.671 date 26.10.2005”.

Duke vleresuar rendesine jetike qe ka marrja e masave per luften kunder financimit te terrorizmit eshte treguar kujdes edhe ne lidhje ne zbatimin e 40+9 rekomandimeve te FATF-es, te cilat kane krijuar kuadrin e plote ligjor ne luften kunder financimit te terrorizmit.

Sic rezulton, ndryshimet dhe permiresimet ligjore ne kete fushe jane dinamike. Eshte krijuar nje baze e forte ligjore per vete natyren, rrezikshmerine dhe kerencimin global qe ka fenomeni i financimit te terrorizmit, kjo edhe si rezultat i perfitimeve nga disa rrethana lehtesuese autoreve si rezultat i renies se barrierave per levizjen e lire te njerezve e te kapitaleve, globalizmi i tregjeve nderkombetare, zhvillimi i teknologjise se informacionit dhe persosja e sistemit elektronik te transfertave bankare nga nje vend ne tjetrin.

NIF shqiptar pervec detyrimeve te legjislacionit vendas ka zbatuar detyrimet e percaktuara ne shtate Rezolutat e Keshillit te Sigurimit te Kombeve te Bashkuara.

### **3. OBJEKTIVAT PER VITIN 2006**

#### **Sistemi i Teknologjise se Informacionit.**

Per shkak te volumit te madh te informacionit financiar qe duhet te merret, kerkohet dhe analizohet, perdorimi efektiv i teknologjise se Informacionit eshte sfida me e rendesishme per tu zgjidhur gjate vitit 2006. Eshte e besueshme qe me asistencen e premtuar te Komunitetit European, NIF do te jete ne gjendje te implemetoje nje sistem te dhenash te kompjuterizuar ne vitet ne vazhdim..

#### **Rritje te numrit te referimeve kriminale dhe korrupsionit**

Gjate vitit 2006, NIF do te beje perpjekje te bashkerenduara per te rritur numrin e referimeve per perndjekje kriminale. Me ndihmen e nje sistemi te dhenash te kompjuterizuar dhe nje stafi me te gjere analistesh, numri I referimeve do te rritet ne menyre te dukshme. Ne kete pike, duke qene se blerja e nje sistemi te dhenash

nuk eshte siguruar plotesisht, nuk mund te behen vleresime sasiore per rezultatet e vitit 2006.

Rritje ne numrin e ngrirjeve te asetave te terroristeve. Ne te njejten menyre NIF do te beje nje perpjekje per te rritur numrin e ngrirjeve te asetave te terroristeve te inicuar gjate 2006. Kjo do te behet e mundur permes nje marreveshje me te forte me Agjensite e zbatimit te ligjit si dhe me Agjensine per Administrimin e Asetave te Sekuestruara dhe Konfiskuara.

Rritje ne numrin e inspektimeve “on-site”. Me nje staf me te madh inspektoresh, numri i vizitave ne entitetet qe kane detyrimin ligjor per te raportuar do te rritet ne menyre substanciale. Nje plan eshte skedular por vizitat do te jene te palajmeruara tek te gjitha bankat kryesore dhe institucionet e tjera financiare gjate vitit 2006.

Rritje ne bashkepunimin nderkombetar. Duke vazhduar perpjekjet e filluara ne vitin 2005, NIF do te zgjeroje numrin e Memorandumeve te Mirekuptimit me njesite homologe te pakten ne tridhjete deri ne fund te vitit 2006. Ketu do te perfshihen Greqia, Turqia, Australia dhe Moldavia.

Iniciativa per personat e ekspozuar politikisht. Kjo initiative eshte e detyrueshme nen kerkesat e Direktives se Trete te BE-se. Personat qe mbajne apo kane mbajtur pozicione te larta publike do te jene subjekt i “due diligence” te rrepte nga institucionet financiare. Ne bashkepunim me Inspektoriatin e Larte te Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive, NIF do te verifikoje personat qe plotesojne kete kriter ne Shqiperi dhe do te veproje per te siguruar implementimin e kerkesave te kesaj Direktive duke filluar nga viti 2006.

**Iniciativa legjislative.** NIF ka kontribuar aktivisht ne procesin e permiresimeve legjislative. Ne Qershor 2003, Task Forca e Veprimit Financiar publikoi listen e permiresuar te rekomandimeve qe duhet te adoptoheshin nga te gjitha vendet per te forcuar rregjimet e tyre kunder pastrimit te parave dhe kunder financimeve te terrorizmit. Kjo beri te domosdoshme nje rishikim te plote te kornizes legjislative ne fushen e pastrimit te parave.

Gjate vitit 2006, ne nje perpjekje per te forcuar programin dhe per te rritur zbulimet e transakcioneve kriminale, NIF-I do te propozoje disa amendime ne ligjin ekzistues te parandalimit te pastrimit te parave. Keto amendime perfshijne: uljen e pragut te raportimit ne 50.000,00EURO dhe kerkesen qe te gjitha transakcionet ne “real estate” te kryhen nepermjet bankes. Ulja e pragut te raportimit presupozon natyrisht blerjen e nje qendre te dhenash. Nje tjetere perpjekje ligjore perfshin draftimin e akteve nenligjore dhe rregulloreve te brendshme per te implementuar plotesisht ligjin mbi shtypjen e financimit te terrorizmit.

**Ndergjegjesimi i Publikut dhe Programet ne Komunitet.** NIF ka ndermarre nje numer iniciativash per te ndergjegjesuar publikun lidhur me kerkesat kunder pastrimit te parave. NIF ka iniciuar nje fushate publicitare duke perfshire mesazhe promocionale ne radio dhe TV per te informuar publikun rreth aspekteve negative te ekonomise informale dhe potencialit te saj per korrupsion dhe kriminalitet. Ne

vecanti, mesazhi ka synuar te beje te ndergjegjshem publikun mbi denimet penale dhe mast administrative per mosdeklarimin e parase CASH ne pikat e kalimit te kufirit dhe demin qe sjell tregu informal valutor.

Ndergjegjesimi i pergjithshem dhe seminarret ne subjekte lidhur me pastrimin e parase dhe financimin e terrorizmit jane planifikuar per agjensite qeveritare si Drejtoria e Pergjithsme e Tatimeve, Doganave dhe bankat e nivelit te dyte. Gjithashtu, jane planifikuar seminare edukative dhe trainime duke parashikuar perfshirjen e profesioneve te tilla si noteret, avokatet, auditoret financiare ne sistemin e detyrueshem per raportim.

### **Zhvillimi i stafit**

Gjate vitit 2006, numri i stafit do te rritet ne 22, kryesisht me background ekonomiste dhe juriste. Me asistencen e Komisionit European dhe Departamentit Amerikan te Thesarit, zhvillimi i stafit dhe trajnimi do te jete nje process I vazhdueshem gjate vitit 2006.

### **3.1 Plani Strategjik**

Gjatë pesë viteve të kaluara kanë ndodhur shumë ndryshime në NIF. Është rritur nga një agjenci e vogël me vetëm dhjetë punonjës, në një dyfishim të këtij numri dhe me një rol më të madh në luftën kundër krimit dhe korrupsionit në Shqipëri. Ka ndodhur shpesh në të kaluarën, që ndërsa ngarkesa e punës në agjencitë tona partnere është gjithmonë në rritje dhe fokusi i aktivitetit të tyre është më i përqëndruar, strategjitë tona shpesh duhet të rindërtohen dhe reformohen me shpejtësi të madhe.

NIF nuk mund të përballojë më veprimin pa një plan strategjik afat gjatë, avant-garde. Përmasat dhe misioni i tij kërkojnë një strukturë solide me planifikim strategjik dhe taktik, të mbështetur nga procedura biznesi të menduara mirë. Gjatë vitit 2005, ne e filluam këtë punë duke rishikuar rolet e stafit manaxhues dhe egzekutiv si dhe duke klasifikuar proceset e brendëshme. Këto studime u shndërruan më pas në baza për strukturën tonë të tanishme organizative. Gjatë vitit 2006, ne do të vazhdojmë të formulojmë një plan strategjik afat gjatë.